

VAKSINIMI KUNDËR MENINGOKOKUT: KËSHILLA TË REJA MBI VAKSINIMIN NË MUAJIN E 15-TË

Këshillë

Këshilli i Lartë për Shëndetin **rekomandon** që **vaksina falas kundër meningokokut C** (NeisVac-C®), e cila aktualisht aplikohet në muajin e 15-të, të zëvendësohet nga **vaksina kundër meningokokut ACWY** (Nimenrix®). Kjo vaksinë nuk është falas. Meningokokët janë baktere. Ekzistojnë tipa të ndryshëm, prej të cilëve tipat A, B, C, W dhe Y janë të rrezikshme për njeriun. Ato mund të shkaktojnë inflamacion të cipës së trurit, inflamacion të trurit dhe helmim gjaku.

Përse rekomandohet vakcina kundër meningokokut ACWY nga Këshilli i Lartë për Shëndetin?

Në vitin 2018, në Belgjikë (sikurse edhe në vendet fqinje evropiane) pati një rritje të infeksioneve me origjinë nga bakteri i meningokokut, të shkaktuara nga serotipat W dhe Y. Aktualisht numri i infeksioneve nga bakteri i meningokokut është i qëndrueshëm. Mundësia e një infeksioni meningokoksik mbetet e kufizuar, por infeksioni mund të jetë shumë serioz.

Përse vakcina nuk është ende pjesë e skemës bazë të vaksinimit falas?

Aktualisht numri i rasteve mbetet i kufizuar.
Për këtë arsye vakcina aktualisht nuk ofrohet falas në zonën flamande.

Përfunduar nga detyrimi

Si prind ju gëzoni të drejtën e marrjes së këtij informacioni dhe, për këtë arsye, përkundrejt asnjë lloj detyrimi, ne kërkojmë të dimë prej jush nëse dëshironi ta vaksinoni fëmijën tuaj. Në këtë rast, mjeku në konsultoren e fëmijëve, gjatë konsultës së kryer për fëmijën 15 muajsh, rekomandon kryerjen e kësaj vaksine në vend të asaj falas për meningokokun e tipit C.

Çmimi

Vaksina kundër meningokokut ACWY gjendet në farmaci dhe kushton **52,60 euro**. **Vaksina merret në farmaci me recetë** nga mjeku dhe e merrni me vete vaksinën gjatë konsultës që kryhet në moshën 15-muajshe. Informohuni pranë kompanisë tuaj të sigurimit shëndetësor mbi mundësinë e kompensimit të çmimit të blerjes së kësaj vaksine. Për këtë kërkon një vërtetim nga farmacia.

Skema e përgjithshme e vaksinimit të rekomanduar

Vaksinim kundër	8 javë	12 javë	16 javë	12 -muajsh	15 -muajsh ⁽¹⁾	5-7 vjeç	10-13 vjeç ⁽⁴⁾	14-16 vjeç
Poliomielit								
Difteri (grykët e bardha)								
Tetanos								
Pertussis (kollë e mirë)								
Haemophilus influenzae tip B (inflamacion i cipës së trurit)								
Hepatit B (verdhëza)								
Pneumokokët ⁽¹⁾ 13-serotipa								
Rotavirusi ⁽²⁾								
Fruth								
Parotit (shyhat)								
Rubeolë								
Meningokokët e tipit C ose ACWY ⁽³⁾ (inflamacion i cipës së trurit)								
Virusi i papilomës njerëzore ⁽⁴⁾								

- falas
- kundrejt pagesës
- vakcina e kombinuar: 1 injeksion

(1) Me moshë gestacionale më pak se 37 javë:

- Jepet një dozë shtesë kundër pneumokokëve në moshën 12-javëshe.
- Vaksinat e moshës 15-muajshe bëhen në moshën më të hershme 13-muajshe.

(2) Vakcina e rotavirusit kushton afërsisht 12 € dhe jepet me përshkrim të mjekut. Të ruhet në frigorifer në temperaturën (2-8°C) Në varësi të markës, janë të nevojshme 2 ose 3 doza.

(3) Këshilli i Lartë për Shëndetin rekomandon vaksinimin kundër meningokokëve ASWY, në vend të vaksinës kundër meningokokut të tipit C. Vakcina ACWY kushton afërsisht 53 €. Të ruhet në frigorifer në temperaturën (2-8°C)

(4) Viti i parë i arsimit të mesëm të ulët. 2 doza në një interval prej 6 muajsh.

Pika të veçanta në vëmendje:

Agjencia 'Fëmija dhe Familja' rekomandon fuqimisht zbatimin e kësaj skeme të plotë, të propozuar nga Këshilli i Lartë për Shëndetin në Belgjikë.

E detyrueshme me ligj është vetëm kryerja e vaksinës së poliomielitit.

Për bërjen e vaksinës keni mundësinë e zgjedhjes së lirë midis qendrës konsultore 'Fëmija dhe Familja, mjekut të familjes ose pediatrit.

Përveç vaksinave të skemës bazë, ekzistojnë edhe vakcina të tjera që bëhen me qëllim të mbrojtjes së fëmijës tuaj nga meningokoku i tipit B, variçela dhe hepatiti A. Këshillohuni për këtë me mjekun tuaj.